

Dr. Selim Belortaja
Drejtor Ekzekutiv i ACIT¹

SHQIPËRIA – REFORMA EKONOMIKE DHE INTEGRIMI EUROPIAN

Artikull i botuar tek numuri i parë i “European Commitment”, një revistë tremujore e Qendrës Europiane, Tiranë, Mars 2004

Përmbajtja:

<i>Hyrje</i>	<i>1</i>
<i>1. Sukses i brishtë</i>	<i>2</i>
<i>2. Ringritje e shpejtë</i>	<i>5</i>
<i>3. Rritje e qëndrueshme?</i>	<i>6</i>
<i>4. Liberalizimi tregtar dhe integrimi</i>	<i>9</i>
<i>5. Marrdhëniet ekonomike me BE: nga asimetria drejt simetrisë</i>	<i>12</i>
<i>6. Procesi i Stabilizim Asocimit – garant i reformave</i>	<i>14</i>
▪ Referencat	16

¹ Qendra Shqiptare për Tregtinë Ndërkombëtare, Tiranë

Hyrje

Shqipëria hyri në dekadën e fundit të shekullit XX, si vendi me i varfër e më i mbyllur i Europës, me një përqindje veçanërisht të lartë të fuqisë punëtore në bujqësi (rreth 62 %); me një organizim komunist tepër ortodoks të ekonomisë; me popullsi të lodhur dhe tërësisht të izoluar në marrëdhëniet me të huajt; me një sistem të mbyllur të tregut të brendshëm; me një shkallë të pazakontë autarkizmi dhe për rrjedhojë me një prirje të theksuar drejt industrisë së rëndë dhe prodhimit të drithrave; me një rritje të lartë të popullsisë dhe të vetë fuqisë punëtore; dhe me një histori të ndërprerjes së vazhdueshme të orientimit të tregtisë së jashtme në vartësi të ndryshimit të shpeshtë të aleancave politike në skenën ndërkombëtare.

Krahas përparësisë absolute kushtuar ushtrisë dhe fortifikimit të vendit, e gjithë sforcja buxhetore e sitemit, e bazuar mbi privacionet ekstreme materiale të popullsisë, u përqëndrua në ruajtjen e disa standarteve të pranueshme në sistemin shëndetësor dhe atë arsimor.

Kjo ishte pamja me të cilën Shqipëria filloi rrugën e gjatë të transformimit të sistemit. Më 15 Tetor 1991, ky vend deriatëhere simbol i antitregut u bë anëtar i FMN dhe Bankës Botërore. Ai vinte në institucionet e Bretton Woods-it pas dekadash trulllosje ideo-propagandistike mbi rolin e imazhin e tyre, pa asnjë eksperiencë të mëparëshme mbi rregullat dhe instrumentat e konkurrencës, me një klimë tensionesh të mprehta sociale që i shtoheshin tensioneve historike të rizguara në atmosferën rajonale. Nga ana tjetër, instabiliteti politik dhe kaosi administrativ që shoqëroi desintegrimin e ekonomisë së planifikuar më 1991-1992 prodhuan një deficit të thellë buxhetor, ndërsa liberalizimi i menjëhershëm i çmimeve dhe refuzimi i çdolloj gradualizmi sollën një goditje të fortë inflacioniste, tkurrje të prodhimit dhe përkeqësim të menjëhershëm të treguesve socialë si papunësisë, shërbimeve sociale, e sigurisë së përgjithëshme.

Hapat që pasuan treguan se shoqëria shqiptare, edhe pse e lodhur deri në deformim nga një prej diktaturave më të egra që ka njohur bota, e kishte bërë përfundimisht zgjedhjen e saj. Pavarësisht nga privacionet dhe kostot e tranzicionit, kosto që vazhdojnë të paguhet ende si rezultat i dobësive qeverisëse dhe të politikës në përgjithësi, rruga demokratike dhe integruese vazhdon të gëzojë konsensusin më të gjerë në të gjithë spektrin dhe segmentet e shoqërisë shqiptare.

Mbas 12 vitesh të reformës Shqipëria është bërë një vend i hapur, i vendosur të shkojë pa dilema në rrugën e demokracisë dhe ekonomisë së tregut. Shoqëria shqiptare po bëhet gjithnjë e më e vetëdijshme se integrimi në botën e zhvilluar është një raport angazhues midis përfitimeve dhe detyrimeve. Stabiliteti makroekonomik, rritja e prodhimit, reformat strukturore, shkalla e vetëfinancimit të ekonomisë, kontributi i lartë i sektorit privat në PBB kombëtare, përpjekjet për forcimin e rendit e sigurisë, përmirësimin e infrastrukturës dhe klimës së biznesit, prioritarizimi i arësimit, shëndetësisë dhe kujdesit social, tentojnë t'i bëjnë rezultatet e tranzicionit më të prekëshme për qytetarët. Edhe më i rëndësishëm se sa ndryshimet në treguesit kuantitativë të ekonomisë dhe infrastrukturës fizike të vendit është ndryshimi

i thellë që ka ndodhur në mentalitetin e tyre, duke bërë që sjellja sociale të zhvillohet në një linjë me kërkesat e reformave dhe modelit politiko-ekonomik që vendi aspiro. Gradualisht po kapërcehen edhe iluzionet fillestare të euforisë konsumiste dhe bashkangjites mekanike me botën e zhvilluar dhe shoqëria shqiptare po kupton më mirë sfidat e përgjegjësitë e një rruge të gjatë, dhe ende me plot të panjohura për të.

Me vendimin e Qershorit 2001 për fillimin e punës për një program Stabilizim – Acocimi me Shqipërinë dhe miratimin më pas nga Këshilli i Ministrave të BE të mandatit përkatës, më 31 Janar 2003 Komisioni European shpalli zyrtarisht hapjen e negociatave për Marrveshjen e Stabilizim Asocimit me Shqipërinë, e cila do të zëvendësojë Marrveshjen aktuale për Tregtinë dhe Bashkëpunimin, hyrë në fuqi më 1 Dhjetor 1992. Ky ishte finalizim i një rruge të gjatë përpjekjesh politike, teknike e diplomatike. Ndërkaq viti i negociatave intensive 2003, krahas volumit të punës së dobishme dhe numurit të çështjeve të shqyrtuara dëshmoi edhe se ndryshe nga euforia fillestare, hapja e negociatave nxorri edhe më në pah distancën me standartet e kërkuara dhe difektet në realizimin dhe menaxhimin e reformës. Kjo është arsyeja pse pavarësisht precedenteve të mbylljes së negociatave me vendet e tjera në një kohë shumë të shkurtër, BE deklaroi se *“koha për përfundimin e këtyre negociatave do të varet në një masë të madhe nga aftësia e autoriteteve shqiptare për të zbatuar një numur reformash kyçe si dhe nga përkushtimi e vendosmëria e tyre në këtë kontekst”*²

1. Sukses i brishtë

Reformat ekonomike dhe politike të tranzicionit filluan me një hap të konsoliduar mbas Marsit 1992. Qeveria e parë jokomuniste (Partia Demokratike), e motivuar nga një vullnet i theksuar reformist dhe nga një mbështetje e gjerë popullore, u angazhua në një program reformash radikale në fushën e institucioneve dhe transformimin ekonomik.

Progresi në këtë fazë fillestare të tranzicionit ishte i shpejtë dhe befasues, duke e renditur Shqipërinë ndërmjet vendeve më të avancuara përsa i përket ritmit e thellësisë së procesit reformues. Brenda një periudhe prej tre vjetësh rreth 70% e ekonomisë ishte privatizuar; çmimet dhe tregtia ishin liberalizuar pothuajse tërësisht; politikat e shtrënguara monetare e fiskale çuan në një stabilitet makroekonomik për t'u admiruar (inflacioni në 1995 ishte vetëm 7% kundrejt 231% në 1991, defiçiti buxhetor ishte vetëm 10% GDP në 1995, krahasuar me rreth 50% të GDP në 1991, ndërsa të kursit luhatës i këmbimit i aplikuar në 1992 solli një stabilitet të qëndrueshëm të vlerës së lekut).

Përgjigja ndaj këtyre reformave erdhi shumë shpejt, sektori i porsa lindur privat u tregua tepër dinamik duke sjellë shpejt kontributin më të madh në

² EC-paper: **The Western Balkans in transition** by Directorate-General for Economic and Financial Affairs, N° 5 January 2004

rritjen e përgjithshme ekonomike. Në periudhën 1993-1996 ndërsa shumë nga vendet e tranzicionit kishin ritme negative të rritjes, Shqipëria pati një ritëm mesatar rritjeje prej 9,5 % në vit, tepër i lartë madje dhe për standartet e rajoneve dinamike si ai i Azisë Juglindore.

Hyrja në fuqi me 1992 e Marrveshjes mbi Kooperimin Ekonomik dhe Tregtinë me BE, përfshi deklaraten e përbashkët për Dialogun Politik, i parapriu një riorientimi të menjëhershëm të tregtisë shqiptare. Po atë vit Shqipëria u përfshi në listën e vendeve GSP duke përfitur nga avantazhet e një rregjimi preferencial që BE zbatonte prej kohësh me një numur të madh vendesh. Kjo si dhe një numur faktorësh të tjerë si afërsia gjeografike dhe potencialet e pashfrytëzuara në tregtinë me vendet e BE, emigracioni masiv, dhe ekzistenca e fuqisë punëtore të lirë e relativisht të kualifikuar për operacionet “fason” bënë që Shqipëria të orientohej thuajse tërësisht nga tregtia me BE (Tab. 1).

Tab. 1 Pjesa e tregtisë që çdo vend i EJL bën me BE dhe me grupin e EJL 1999-2002

	EXPORTET DREJT BE				IMPORTET NGA BE				EXPORTET EJL		DREJT EJL		IMPORTET NGA EJL			
	1999	2000	2001	2002	1999	2000	2001	2002	1999	2000	2001	2002	1999	2000	2001	2002
Shqipëria	93.1	90.8	89.9	89.4	80.2	76.6	78.3	77.8	2.5	2.7	2.8	3.1	4.6	5.9	5.3	6.3
B&H.	Na	38.3	40.1	30.3	Na	29.8	31.3	29.8	na	29.3	29.2	35.8	Na	21.8	22.8	24.7
Bullgaria	54.2	51.7	55.2	56.3	50.0	45.0	49.8	51.6	9.9	12.8	9.8	9.0	2.2	4.4	3.0	2.7
Kroacia	49.4	54.9	54.3	52.3	56.6	56.0	55.7	55.8	14.6	13.4	13.9	16.4	2.4	2.0	2.5	2.8
FYRoM	44.8	42.5	43.3	40.1	40.0	38.2	49.1	47.3	30.5	33.7	39.8	43.6	19.8	17.5	18.4	20.1
Rumania	65.5	63.9	68.0	67.9	60.5	56.7	57.4	63.9	3.1	4.7	3.6	3.0	1.2	1.3	1.3	1.3
Serb/MZi	36.4	36.8	41.5	40.8	41.5	36.9	36.9	42.6	34.4	30.7	27.4	29.4	24.2	22.0	14.9	12.1

Burimi: Prof. Milica Uvalic, Paper presented in the Simpozium on International Trade, organised by ACIT/MoE, 2003

Përsa u përket investimeve të huaja, treguesit e Shqipërisë deri në 1996 ndonëse modeste, (stoku global prej 130 milion dollarë amerikanë, ose më pak se 40 \$ per frymë), ishte i krahasueshëm me atë të shumë vendeve të tjera në tranzicion. Ndërkohe, Shqipëria përfitoi një ndihmë të madhe (rreth 1 miliard USD deri në 1996) nga donatorët dhe institucionet ndërkombëtare financiare.

Një kuadër ligjor demokratik u prodhua në këto pak vite, së bashku me ndërtimin e institucioneve bazë të demokracisë dhe të një administrate publike shumë më kualitative e efçente se e mëparshmeja. Përveç antarësimit në institucionet financiare ndërkombëtare, Shqipëria u pranua relativisht shpejt edhe në Këshillin e Europës, dhe më vonë në OSBE, duke konturuar një politike të jashtme të orientuar drejt integritimit në Europë dhe strukturat Euro-Atlantike.

Ne analizat e bera nga eksperte dhe institucione të huaj gjate viteve 1994-1996, nuk ishte i rrallë rasti i përmendjes së Shqipërisë si një **rast i veçantë** i tranzicionit të suksesshem.

“Shqipëria u rimëkëmb shumë shpejt nga recesioni tranzicional dhe gjatë viteve '90 regjistroi një rritje ekonomike të përgjithshme impresionuese shoqëruar nga stabiliteti makroekonomik dhe ekspansioni i shpejtë i sektorit privat. Ndryshe nga sa mendohej, dimensionet e vogla të vëndit,

reperkusionet e shumfishta të nivelit të ulët të zhvillimit ekonomik që trashëgonte, pesha e parëndësishme e marrdhënieve me botën e jashtme, dhe kontrolli i ngurtë administrativ nën një planifikim qendror tepër ortodoks, nuk u bënë dot një pengesë e pakapërcyeshme ndaj zhvillimit drejt një rendi ekonomik të bazuar tek tregu. Më shumë se katër dekada izolimi dhe ndalimi të të aktivitetit ekonomik privat nuk arriti të shuajë shpirtin sipërmarrës, gjë që duket qartë nga shpërthimi i biznesit privat në gjithë Shqipërinë”-thuhet në një analizë recente të Bankës Botërore”³

Nga ana tjetër duhet përmendur që “kostoja” e tranzicionit që tepër e rëndë për popullatën e shoqërië shqiptare. Liberalizimi dhe privatizimi sollën mbylljen e detyruar mjaft industrive shtetërore çka prodhoi një papunesi që në vitet 1992-1993 arriti në nivelin e 28,5% shifër e cila deri më sot pavarësisht statistikave të matura në bazë të regjistrimeve të punëkërkuësve mendojmë se vazhdon të mbetet në nivele të përafërta. Kategori të tera sociale, pensionistet, të papunet e nepunesit shtetëror u gjenden në nivele të ardhurash personale që i klasifikonin ata në kategorite me të varfëra të shoqërië. Varferia ishte më e gjërë në fshat, më e ashpër në qytete dhe pothuajse dëshpëruese në zonat e prapambetura sidomos ato të Veriut e Verilindjes së vendit.

Pamja e mësipërme, e suksesshme dhe optimiste, e bënë të vështirë shpjegimin e një prej traumave më të mëdha që ka kaluar Shqipëria: krizës së rëndë politike e sociale të vitit 1997. Kjo krizë kapi në befasi madje dhe analistët më skeptikë të tranzicionit post-komunist. Rezultatet e një progresi të arritura në pesë vjetet e para nepermjet vështiresive e kostove të larta sociale, avulluan pothuajse në çast.

Paraliza e plotë dhe e menjëhershme e institucioneve shtetërore, humbja e rendit publik, anarkia sociale dhe aktet e violences dhe shkatërrimeve që pushtuan Shqipërië nuk ishin ngjarje aksidentale dhe as u shkaktuan nga faktorë të rastit. Shkaqet e krizës shtrihen në një kontekst të gjërë historik të zhvillimit të shoqërië shqiptare, por padyshim ndikim vendimtar në prodhimin e tyre patën disa fenomene të prodhuara gjatë vetë periudhës së tranzicionit. Dobësia dhe fraxhiliteti i institucioneve shtetërore, mosbesimi publik në vetë institucionet politike, ishin shfaqja më e shprehur e krizës, ndërsa falimentimi i skemave piramidale, ku mbi 50% e shqiptarëve kishin vendosur kursimet e tyre, u perceptua si shkak i drejt i saj.

Sigurisht kjo krizë tragjike nuk u shkaktua thjesht dhe ndoshta as kryesisht nga faktorë ekonomikë. As vështiresite e mëdha ekonomikë e sociale të tranzicionit, natyrshëm të krijuara nga reformat transformuese, dhe as humbjet e mëdha financiare të popullatës në skemat piramidale, nuk ishin shkaqet e mjaftueshme për të prodhuar atë trazirë sociale tragjike.


Gjykojmë se në rradhë të parë ky ishte një paralajmërim i madh ndaj politikave arbitrare e të papërgjegjësme.

³ Trade policies and institutions in the countries of South Eastern Europe in the EU Association and Stabilisation Process, *Regional Report*, June 28, 2002, Poverty Reduction and Economic Management Group Europe and Central Asia Region, Document of the World Bank

2. Ringritje e shpejtë

Pa qenë i lehtë për t'u shpjeguar, është një fakt impresionues që shqiptarët pavaresisht vështiresive të mëdha ekonomike, traumave sociale e psikologjike të këtij transformimi radikal, përgjate këtyre dymbëdhjetë vjeteve kanë dëshmuar një kurajo të veçantë në përballimin e vështiresive, si dhe një forcë rigjeneruese e energji progresi që duhet të njihet dhe të respektohet.

Një tregues i kësaj energjie gjatë periudhës së tranzicionit ishte **aftësia e vendit për t'u rimëkëmbur shpejt ekonomikisht**. Pas një rënije prej 30% në outpute në fillim të vitit 1992, gjatë viteve 1993-1996 ekonomia kishte shënuar një rritje që shkoi nga 7 deri në 11% të GDP-së (Graf. 1).



Por aftësia rigjeneruese e shfaq më e qartë pas krizës së vitit 1997. Pas një rënije prej -7% , duke filluar nga viti 1998 e deri më sot GDP-ja vjetore ka pasur një vlerë prej 7-8 %. Ndonëse është vështirë të shpjegohet, fenomeni shqiptar i rimëkëmbjes së shpejte (ndërkohë që të gjitha vendet tjera të SEE pësuan recesione apo paten vlera mjaft të ulëta rritjeje – rreth 2-3 %) ka disa faktorë të cilët duhën marrë në konsideratë:

- Baza mjaft e ulët fillestare.
- Liberalizimi i shpejtë makroekonomik (fundviti 1992); privatizimi i shpejtë i tokës bujqësorë, tregtisë dhe shërbimeve (brenda vitit 1993)
- Aftësia e dukshme e popullsisë për t'iu përshtatur praktikave të inisiativës së lirë dhe dinamizmi i sektorit privat që po lindte.
- Emigracioni i shpejtë dhe në mase drejt vendeve fqinje, kryesisht Greqisë dhe Italisë (rreth 20% e të gjithë popullsisë) dhe hyrja e lartë e remitancave të cilat mendohen të kapin vlerën e 350-500 milion USD në vit.
- Ndihma e konsiderueshme nga jashtë gjatë këtyre viteve (rreth 1 bilion USD)

Ky zhvillim i vullshëm kuantitativ i ekonomisë u shoqërua edhe me ndryshimet strukturore përkatëse, duke bërë që dominimi absolut i një sektori

bujqësor ekstensiv të balancohej gradualisht nga sektorë të tjerë “modernë” si ndërtimi, transporti e shërbimet e tjera (Shif Graf. 5)


Forca rigjeneruese e ekonomisë shqiptare duket qartë në faktin se megjithë tronditjen që shkaktoi lufta në Kosovë dhe peshës që mbajti Shqipëria në përbalimin e pasojave të lidhura me ardhjen e mbi 500 000 refugjatëve kosovarë, përsëri treguesit e rritjes ekonomike thuhet nuk u ndikuan duke ruajtur ritmin e lartë⁴.

3. Rritje e qëndrueshme?

A mund të deklarojmë se Shqipëria ka arritur që sot të ketë një rritje të qëndrueshme dhe mundësi të mjaftueshme për t’u përfshitë në BE në një të ardhme të afërt?

Po të nisemi nga një stabilizim relativ të treguesve bazë të zhvillimit ekonomik pas fluktuacioneve të mëdha deri në vitin 1993, përgjigja duhet të jetë optimiste.

Graf. 2: PBB reale, inflacioni dhe deficiti i përgjithshëm



Source: IMF Country Report No. 01/118, July 2001.

Por një përgjigje pozitive definitive do të ishte tepër optimiste dhe larg realitetit. Kjo për disa arsye:

Së pari, rritja e outputeve gjatë këtyre viteve ka qënë më tepër një “rimëkëmbje” sesa një “ritje e qëndrueshme”. Për “ritje” dhe “qëndrueshmëri” flitet kur një ekonomi shënon rritje të konsiderueshme në asete dhe produkte kapitale, investime të rëndësishme në teknologji si dhe rritje konkrete në nivelin e arsimimit dhe atë profesional të kapitalit njerëzor⁵. Asnjëri nga faktorët e sipërpërmendur nuk është realizuar në mënyrë të dukshme në ekonominë shqiptare deri më tani. Niveli i FDI-ve është një ndër


⁴ Riccardo Faini, 2001. “Macroeconomic Stabilization during the Transition: Albania’s experience in a comparative perspective.” *mimeo*. Ministero dell’Economia and CEPR, December.

⁵ See for more “Inter-European Trade-offs and Dilemmas”, D.Daianu, “The Balkans and the challenge of Economic Integration”, 1997

më të ulët të rregjistruar midis vendeve në tranzicion (160 USD për frymë në vitin 2000); pjesa më e madhe e GDP-së vjen nga bujqësia (afërsisht 50%) dhe tregtia, ndërkohë që kontributi i sjellë nga industria mezi arrin vlerën 10%⁶

Aktiviteti ekonomik është përqëndruar rreth kryeqytetit të vendit dhe disa zonave urbanë. Ekonomia e sotme është thuajse krejtësisht e orientuar nga importet dhe deficiti i jashtëm vazhdon të jetë tepër i lartë (importet i kapërcejnë 5 herë eksportet). Bujqësia, e cila deri tani ka shënuar rritjen më të lartë dhe sjell pjesën më të madhe të GDP (Graf.3), po jep sinjale ngadalësimi, shkaktuar kjo nga mangësi strukturore lidhur me përmasat tepër të vogla të fermave (1 – 1.5 ha) dhe tregtinë e tokës që ndodhet vetëm në fillimet e saj. Varfëria është në rritje dhe në disa pjesë të vendit arrin nivelet e vendeve të pazhvilluara. (17.4 % e popullsisë ndodhet në varfëri të plotë).

Graf 3: Kontributi i sektorëve të ndryshëm në rritjen e PBB (1992-2000 (në %))



Source: Trade policies and institutions in the SEE countries in the EU Association and Stabilization process, ËB, Regional Report (draft), 2002

Së dyti, zhvillimi i qëndrueshëm është i papajtueshem me nivelin e varfërisë së vendit dhe mbetet seriozisht i kërcënuar nga kjo varfëri. Me një nivel të ardhurash për frymë prej vetëm 1400 Euro⁷ ose 4 herë më të ulët se sa Kroacia, tensioni për deformim të zhvillimit normal mbetet i lartë.

Polarizimi i shoqërisë, pabarazia dhe **varfëria** ekstreme e një pjese të konsiderueshme të popullsisë janë më të theksuara se në të gjitha vendet e tjera të Europës Qendrore e Juglindore (vlera e treguesit GINI në vitin 1998 ishte 0.43). Ndonëse niveli zyrtar i varfërisë në Shqipëri është caktuar shumë i ulët (konsiderohet e varfër ajo familje shqiptare me më pak se 6500 lek ose rreth 50 Euro në ditë), rreth 20% e popullsisë shqiptare ndodhet nën këtë nivel ndërkohë që një e pesta e popullsisë jeton me më pak se 1.2 Euro në ditë⁸. Niveli i arsimimit të popullsisë ka rënë ndjeshëm dhe fenomeni i përhapur i emigrimit të elitës kulturore e profesioniste ka varfëruar në mënyrë të konsiderueshme cilësinë e kapitalit njerëzor.

⁶ Bank of Albania, "Economic Bulletin", December 2001

⁷ Commission of the European Communities: Albania – Stabilization and Association Report, 2002

⁸ European Commission, "Albania – Country Strategy Paper 2002-2006", November 2001

Ky konstatim social si dhe nevoja për një horizont afatmesëm në veprimtarinë qeverisëse ka qënë në bazë të konceptimit të **GPRS dhe planifikimit trevjeçar të buxhetore**.

GPRS shënon iniciativën e parë me pronësi tërësisht kombëtare, të mbështetur fuqimisht nga Banka Botërore dhe donatorët e tjerë, për realizimin e një programi të ndërhyrjeve qeveritare në një plan afatmesëm. Duke marrë në analizë procesin e transformimeve ekonomike të një dekade tranzicion, ky dokument evidenton dhe burimet akoma të pashfrytëzuara të rritjes ekonomike, duke u fokusuar në rritjen gjithpërfshirëse. Nëpërmjet identifikimit të barrierave të rritjes ekonomike dhe kërcënimeve të stabilitetit makroekonomik të vendit, plani i masave publike prioritare synon pikërisht në lehtësimin e këtyre barrierave. Një tipar i rëndësishëm i GPRS është gjithashtu se ai shërben si orientues në hartimin e programit afatmesëm buxhetor (PAB) në përputhje me prioritetet tashmë të përcaktuara pas një diskutimi gjithpërfshirës të të gjithë aktorëve.

Së treti, zhvillimi i qëndrueshëm mbetet thellësisht i kërcënuar edhe nga fakti se institucionet e tregut në Shqipëri mbeten ende ose të pakrijuara, ose të paaftha e jofunksionuese. Ndërkohë që korrupsioni është një tjetër kërcënim për to. Duket se dobësia apo inekzistenca e mekanizmave rregullatorë të tregut, e cila gjatë fazës së parë promovoi e mundësoi prosperimin e biznesit të vogël e akumulimin e kapitalit fillestar, tashmë janë kthyer në një pengesë të vërtetë për zhvillimin.

Monopolet, të hapur apo të fshehur qofshin, mosfunksionimi gati total i mekanizmave të mbikqyrjes së tregut, përmasat shqetësuese të ekonomisë informale e në mënyrë të vecantë asaj kriminale përbëjnë një barrierë të madhe për futjen në FDI, rritjen e investimeve private dhe distortojnë sturkturën e cmimeve, realokimin e burimeve kapitale e njerëzore.

Funksionimi i dobët i mekanizmave institucionalë të tregut bën që ekonomia e treut të lirë privat në Shqipëri të marrë hera herës trajta anarkike, ku instrumentat e tregut shfaqen të dobët apo të deformuar. Përsa i përket sektorit informal të ekonomisë, i cili zë rreth 40% të outputit vjetor⁹, preokupimi më i afërt është aktiviteti kriminal duke përmendur këtu atë njerëzor, trafikimin e lëndëve narkotike, evazionin e madh të taksave, aplikimin diskriminues e selektiv (përzgjedhës) të taksave e tarifave doganore, monopolet (ndonëse shpesh të fshehura) e imputeve dhe ato të tregtisë së brendshme, etj.

Sfidat e vetme strategjike për momentin janë aktivizimi dhe forcimi i mekanizmave të tregut e institucioneve dhe reduktimi i sektorit informal të ekonomisë. Mbrojtja e të drejtave të pronës dhe respektimi i obligacioneve kontraktuale, aplikimi me rigorozitet i *exit mechanisms*, funksionimi i rregullt i organeve rregullatore të tregut dhe mekanizmat anti-trust e anti-dumping janë të paplotësuara formalisht dhe krejtësisht joefektive. Asistenca financiare e teknike e donatorëve në këto drejtime, deri më sot është fokusuar më tepër në draftimin e ligjeve dhe ngritjen formale të autoriteteve e agjensive

⁹ “Albania – Stabilization and Association Report” – Brussels SEC (2002)

respektive ndërkohë që ajo çka nevojitet më tej është, “stafimi”, trainimi dhe mbikqyrja e tyre.

Një barrierë serioze e cila duket se nuk mund të kapërcehet së paku edhe në një periudhë afatmesme mbetet **kriza energjitike** që shpërtheu në dy vitet e fundit si dhe kapaciteti i ulët apo rrjeti joadekuat në rrugë, porte e aeroporte, telekomunikacion e interkoneksionet elektrike, etj.

Sistemi financiar i vendit ka tërësisht pamjen e atij bankar. Megjithëse në Shqipëri operojnë rreth 14 banka private, roli i tyre nuk ndihet në ekonominë e vendit (ndërkohë që totali i depozitave të kursimit llogaritur me 34,8% GDP në vitin 2000, krediti i sektorit privat krahasuar me totalin e depozitave kryesore ishte vetëm 10.2%)¹⁰

4. Liberalizimi tregtar dhe integrimi europian

Në qoftë se në përgjithësi tregtia konsiderohet si faktor i rritjes ekonomike përdërisa bën të mundur orientimin e burimeve prodhuese drejt një përdorimi më eficient, për Shqipërinë roli i saj është veçanërisht i rëndësishëm. Kjo jo thjesht për faktin se Shqipëria është një vend i vogël, pra i paradestinuuar për të pasur një ekonomi të hapur. Qoftë edhe një vështrim i shpejtë mbi ecurinë e tregtisë gjatë dekadës së fundit dhe raportet e saj me zhvillimin e përgjithshëm të vendit, nxjerrin në pah dy kontribute specifike të saj.


Së pari, përmes tregtisë, importit të mbështetur në iniciativën private (pa mohuar rolin vendimtar të ndihmave ekonomike në situata të veçanta), është bërë i mundur plotësimi i nevojave bazë të njerëzve, ndryshimi i profilit të tyre dhe rritja e zgjedhjes së konsumatorëve. Krahasimi i dy periudhave kritike të tranzicionit shqiptar, vitet 1992-1993 dhe viti 1997 nxjerr më mirë në pah rolin e tregtisë si zbutës i krizave: në vitin 1997 ndihmat ekonomike u bënë pothuajse të panevojshme: tregtia e mbështetur në biznesin privat arriti t’u përgjigjet nevojave të tregut.

Së dyti, megjithëse mjaft larg niveleve të dëshiruara, tregtia ka luajtur dhe po luan një rol të rëndësishëm rialokues të burimeve prodhuese. Ndryshimet strukturore në ekonomi, të shprehura në rritjen e peshës së shërbimeve dhe të llojshmërisë tyre, në rritjen e peshës së ndërtimit, transportit, etj., si dhe futja e teknologjive të reja në disa degë të ekonomisë janë shprehje e këtij roli (Graf.4)

Hapat e rëndësishme të viteve të fundit, veçanërisht anëtarësimi i Shqipërisë në Organizatën Botërore të Tregtisë (Shtator 2000) dhe nënshkrimi mbi bazën e Memorandumit për Lehtësimin dhe Liberalizimin e Tregtisë të nënshkruar nga vendet e rajonit në kuadër të Paktit të Stabilitetit të vendeve të EJT i 7 marrëveshjeve dypalëshe të tregtisë së lirë me vendet e rajonit, janë shoqëruar me një reduktim të rëndësishëm të pengesave tregtare.

¹⁰ Bank of Albania, “Economic Bulletin”, No.1, 2002

Graf. 4. Ndryshimi në strukturën e PBB (2001 kundrejt 1992)



Synimi i përcaktuar në Memorandum¹¹ është që 90 në fund të periudhës 6 vjeçare të liberalizohen 90% e volumeve tregtisë bilaterale dhe 90% e linjave tarifore. Së bashku me axhendën tregtare të negociatave për Marrveshjen SA me BE ato përbëjnë finalizimin e një prirje të vendosur liberalizuese që Shqipëria adaptoi qysh në vitet e para të tranzicionit

Regjimi tregtar aktual i Shqipërisë është formalisht mjaft liberal. Në Shqipëri nuk ekziston asnjë kufizim sasior mbi eksportet ose importet; nuk ka taksa doganore mbi eksportet; tarifatat doganore mbi importet kanë shënuar rënie mjaft të madhe; struktura e tarifave mbi importet është thjeshtuar në mënyrë të konsiderueshme.

Megjithatë, zhvillimet e derisotme të tregtisë dëshmojnë për praninë e një sërë **problemeve serioze**.

Së pari, shkalla e hapjes tregtare të vendit është ende mjaft e ulët, krahasuar edhe me vendet e rajonit. (Tab.3).

Shkalla e hapjes së ekonomisë¹²

(X + M)/GDP, në përqindje	1998	1999	2000	2001
Vendet				
Shqipëria	41.3	55.2	59.3	63.6
Bosnie Herzegovina	98.4	78.2	77.1	na
Bullgaria	97.7	99.6	122.1	na
Kroacia	88.8	89.2	95.8	na
Maqedonia	99.8	98	114.4	na
Rumania	56.1	62.6	73.7	na
FR Jugosllavia	66.4	56.0	81.2	na
SEE	72.5	74.8	86.9	na


Së dyti, gjatë gjithë periudhës së tranzicionit Shqipëria ka vuajtur nga një deficit tregtar në përmasa shumë të mëdha. Vetëm rreth 1/5 e importit ka

¹¹ Shif pika 1.2.2 e Memorandumit për Lehtësimin dhe Liberalizimin e Tregtisë, pika 1.2.2, Bruksel, 27 Qershor 2001

¹² Eksport import i mallrave dhe shërbimeve në raport me GDP: Shif Georgi Ranchev, 2001 "Free Trade Zone in Southeast Europe? The Harmonization of Tax and Customs Legislation" Research Paper; për Shqipërinë treguesi është llogaritur sipas të dhënave të Bilancit të Pagesave, botim i Bankës së Shqipërisë, Gusht 2002

qenë mbuluar me të ardhurat valutore të eksportit. Për më tepër, për vitet e fundit deficieti është thelluar më tej. Kjo gjendje reflektohet në një situatë të rënduar si të bilancit të pagesave, ashtu edhe të buxhetit qeveritar, me reflektime negative lidhur me borxhin e vendit.

Graf. 7: Bilanci tregtar në vite, në milionë USD





Burimi: ACIT, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave

Së treti, eksporti vuan nga një shkallë e ulët diversifikimi, duke konsistuar në pak mallra, që përmbajnë një vlerë të shtuar të ulët. Më se 60% e eksportit përbëhet nga mallra të ri-eksportit, si tekstile, këpucë, etj.

Po kaq problematik paraqitet edhe diversifikimi i tregjeve të jashtme. Më shumë se 35% të importit dhe rreth 72% eksporteve janë përqëndruar vetëm tek një partner: Italia. Tregu i BE është destinacioni i më shumë se 92% të eksporteve shqiptare dhe burimi i 75% të importeve (Graf. 7).

Graf.8:Vendet partnere në tregtinë e jashtme të Shqipërisë





Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, ACIT

Së katërti, ende administrimi i tregtisë vuan nga moszbatimi i njëjtë dhe korrekt i ligjeve dhe rregulloreve, nga dukuri të kontrabandës e korrupsionit, etj.

Së pesti, kërkohet një mirëkuptim më i gjerë politik e social për zbatimin e politikave tregtare liberale. Perceptimi që kanë pasur shqiptarët rezultojnë të ketë qënë shumë euforik. Grupet e ndryshme të interesit dhe publiku kanë pritur rezultate më të shpejta dhe nuk e kanë pranuar tërësisht sakrificën e kostove dhe humbjeve që shoqëron përfitimet afatgjatë si rezultat i konkurrencës së hapur. Masat liberalizuese duhet të shoqërohen me një program të gjerë ndërgjegjësimit e ndryshimi mentaliteti për të kuptuar dhe pranuar atë që thotë Leif Pagrotsky¹³: *“Është koha të thuhet hapur se ç’do të thotë në të vërtetë të kërkosh të përmirësosh karakteristikat tregtare të botës. Do të thotë të pranosh që disa njerëz në Europë e kudo gjetkë duhet të përshtaten. Ndonëse të dhimbshme këto fakte duhen marrë përsipër të përballohen para se të trajtohet çështja”*

5. Marrdhëniet ekonomike me BE: nga asimetria drejt simetrisë

Rregjimi Tregtar Shqiperi - BE

Rregjimi tregtar Shqiperi-BE aktualisht përbëhet kryesisht nga një kombinim i dy skemave asimetrike:

Rregjimit autonom asimetrik (*rregullore e 29 Qershorit 1999*)

Rregjimit rajonal asimetrik (*rregullore e 18 Shtatorit 2000*)

Mbi bazën e struktura aktuale të mallrave tona të eksportit dhe lehtësirave të dhëna, raporti i Komisionit Europian llogarit se ky rregjim lejon futjen e lirë të mallrave shqiptare në BE, në nivelin 95 %.

Konkretisht rregjimi Preferencial Asimetrik Rajonal mbështetet në disa parime:

Dhënia e disa preferencave rajonale për një grup vendesh të Evropës Juglindore, objekt i Paktit të Stabilitetit (*Shqiperia, Maqedonia, Kroacia, Bosnje-Hercegovina, etj.*):

¹³ Pagrotsky, Leif, Trade Minister of Sweden

- Shkallezim i lehtësirave të dhena në disa nivele (0%, 6%, dhe 12.5%)
- Përdorim “global” i kuotave nga gjithë grupi i vendeve përfituese, me qëllim nxitje të konkurrencës midis tyre (*kush të shfrytëzojë me tepër nga kuota e përbashkët*)
- Kusht i nevojshëm për përfitimin e rregjimit asimetrik të BE është *vërtetimi i origjinës* së produkteve, të cilat duhet të jenë:
 - Tërësisht shqiptare (prodhuar ose përfutur në vend)
 - me një shkallë të caktuar transformimi në Shqipëri (që të marrin origjinën shqiptare),
 - produktet e prodhuara me lëndë të parë nga BE të levruar nën çertifikatën EUR.1

Pikërisht për shkak të vështirësive në respektimin e këtyre kushteve e standarteve të imponuara, përfitimi nga rregjimi liberal i BE ndaj eksporteve tona ka qenë minimal.

Megjithatë, kryesisht për arsye të faktorëve të përmendur në pikën 1., siç evidentohet edhe nga tabela e mëposhtme, Shqipëria e ruajti dhe forcoi orientimin e tregtisë së jashtme drejt BE më fort se sa vendet e tjera të rajonit.

Axhenda tregtare e negociatave të Marrëveshjes SA me BE

Afati për liberalizimin e plotë deri në krijimin e një zone të tregtisë së lirë me BE-në, që do të fillojë nga 1 janari 2009, duket i arsyeshëm dhe i drejtë. Argumentat për këtë janë: (i) nga kjo periudhë do të ketë hyrë në veprim edhe zona e tregtisë së lirë me vendet e SEE-7; (ii) harmonizohen afatet kohore të vendit tonë me atë të vendeve të tjera që kanë të njëjtën marrëveshje me BE-në (siç është rasti i Maqedonisë., dhe ndoshta do të përshpejtohen këto afate edhe për vendet që akoma nuk janë në proces të negociatave me BE-në: Bosnje, Serbi Mali i Zi dhe Kosovë).

Subjektin kryesor të negociatave nuk e përbëjnë afatet e hyrjes në fuqi të Free Trade Area”, por listat e produkteve për të cilat kërkohet liberalizim gradual. Ashtu sikundër listat e mallrave të ndjeshëm për MTL-të me vendet e rajonit, edhe këto me BE-në përbëhen kryesisht nga produktet bujqësore dhe të agropërpunimit. Lidhur me listat Qendra Shqiptare për Tregtinë Ndërkombëtare (ACIT) ka evidentuar disa probleme.

Kështu për mallrat industriale vëmendje më e lartë i duhet kushtuar harmonizimit me skedulën e angazhimeve tona në OBT

Paketa e re fiskale e miratuar nga Parlamenti shqiptar për 2004, ka reflektuar respektimin e këtyre angazhimeve vetëm për disa grupe mallrash të sektorit të agroindustrisë: birrën, produktet e vajit, peshqit, vezën dhe disa perime (bizele, etj). Ndërkaq edhe për këto mallra kanë filluar përpjekjet për një rinegocim me OBT-në për të riskeduluar afatet dhe për të vendosur shtyrje afatesh të liberalizimit.

Për disa kategori produktesh, për të cilat Shqipëria kërkon mbrojtje deri në fund të vitit 2008, në fakt tarifët doganore janë parashikuar të liberalizohen më shpejt. Të tilla janë disa produkte e nënprodukte të industrisë së drurit e letrës që duhet të ishin bërë 0 me fillimin e vitit 2004, ose produkte të metaleve, pajisjeve elektrike, detergjenteve, kozmetikës, plastike, lodrave, etj. të cilat do të liberalizohen ndjeshëm duke filluar nga 1 janari 2004. Të parat nuk ka kuptim të përfshihen në listat e negociatave me BE-në. Ndërsa për të dytat, kërkohet që fillimisht niveli i aplikuar i tarifës doganore të përputhet

menjëherë me nivelin e tarifës për të cilën është marrë angazhim në OBT e vetëm pas kësaj ose së paku pas fillimit të notifikimit me OBT, të shtrohet kërkesa e një liberalizimi më të ngadalshëm me BE. Ndërkohë harmonizimi me matricën e OBT nuk përbën problem në rastet kur niveli aktual i tarifës së aplikuar është më i vogël se ai për të cilin jemi të angazhuar. Punë kërkohet edhe për produktet bujqësore. Megjithëse është përgatitur një listë e produkteve bujqësore prej 54 produktesh të konsideruar si sensitive, politika e negociatave nga pala shqiptare duhet të qartësohet më tej me argumente mbi politikat që do të zbatohë Shqipëria për këto produkte, dhe të atyre që janë jashtë kësaj liste.

Nga ana tjetër, edhe negociatorët e BE-së duhet të jenë më të gatshëm për t'ju përgjigjur vështirësive të Shqipërisë. Është e qartë se BE-ja i ka akorduar vendeve tona statusin e regjimit tregtar më të favorshëm edhe se në raport me vendet që kanë të nënshkruar Marrëveshjen Europiane. Sidoqoftë, efektet e integritit rajonal do të ishin pozitivisht të inkurajuar nëse klauzolat mbi rregullat e origjinës do të ishin më relaksuese. Nga BE kërkohet (i) *zbatimi i parimit të kumulimit diagonal* në ndjekjen e rregullave të origjinës; (ii) angazhime më konkrete nga BE për lehtësimin e lëvizjes së biznesit; (iii) asistencë në fushën e zbatimit të MTL-vë; (iv) asistencë në fuqizimin e institucioneve që merren me inspektimin dhe certifikimin e mallrave për eksport, me ndjekjen e masave sanitare dhe fitosanitare, etj.

6. Procesi i Stabilizimit Asocimit – garant i reformave

Ngjarjet tragjike në Shqipërinë e '97-ës nuk ishin të vetme dhe as të fundit në rajon. Ato ishin paraprirë nga një seri konfliktesh me përmasa luftërash në procesin e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë. Konfrontime dhe tensione të reja ndëretnike shpërthyen edhe më pas duke treguar se fraxhiliteti ishte një tipar i përbashkët për vendet e Ballkanit. U bë e qartë se situatat konfliktuale nuk ishin më vetëm një potencial latent në mardhëniet intra-rajonale. Ato përbënin tashmë një kërcënim real për dhe investimin e deriatëhershëm të komunitetit donator dhe më e rëndësishmja, për fatin e reformave të nisura.

Duke njohur sa më sipër, Komisioni European konceptoi më 1999 Procesin e Stabilizimit dhe Asocimit si një "frameëork" i ri për ecurinë dhe garantimin e reformave në Europë Juglindore, koncept i cili në Qershor 2000 mori miratimin e Këshillit në Feira dhe në 24 Nëntor 2000 në samitin e Zagrebit gjeti pranimin e plotë edhe të vendeve të rajonit duke u shpallur platforma kryesore për zhvillimin ekonomik social të tyre deri në aksesimin e plotë të BE.

Themi se Procesi i Stabilizimit dhe Asocimit (SAP) është garant i reformave sepse ai bazohet në:

- Perspektivën e garantuar të antarësimit të vendeve në BE, me kusht që të pranohen dhe zbatohen principet dhe standartet themelore që kanë të bëjnë me shtetin ligjor, institucionet demokratike e të konsoliduara dhe zhvillimin e ekonomisë së tregut.
- Nevojën e këtyre vendeve për të zhvilluar marrdhënie bilaterale midis tyre si bazë për një stabilitet më të madh ekonomik e politik në rajon.

- Nevojën që edhe programet e asistencës për këto vende të vihen në funksion të kësaj perspektive politike e ekonomike, duke ruajtur fleksibilitetin e duhur që i lejojnë secilit vend të përcaktojë ritmin e vet të kapërcimit të situatave post-konflikt dhe të adaptimit të *acquis communautaire*¹⁴.

Elemente të tjerë që e bëjnë SAP një garant për të ardhmen demokratike të SEE është edhe fakti se ai është afatgjatë dhe dinamik. Ai mbështet jo çdo hap reformues por “reformën e qëndrueshme”. Ndërsa fleksibiliteti dhe karakteri dinamik i tij pret në evoluimin e tij duke ndjekur zhvillimet në rajon, në vetë BE dhe në botë, dhe aftësimin e tij të vazhdueshëm për të reaguar ndaj krizave të papritura. Pajisja e tij në të ardhmen me instrumenta më efikase për ndihmuar në përballimin e problemeve kronike si dobësia e institucioneve demokratike dhe shtetit ligjor, korrupsioni, ekstremizmi nacional, varfëria dhe përjashtimi social, etj, do ta bëjnë atë një stabilizator real të klimës në rajon duke rritur ndjeshëm bashkëpunimin rajonal dhe atraktivitetin për investimet e huaja.

Shqipëria është një anëtare aktive e Procesit të Stabilizim Asocimit dhe po tregon një vendosmëri të qëndrueshme në përmbushjen e kondicioneve në rrugën e integrimit europian.

Veçanërisht e vemendëshme ka qene Shqipëria në plotësimin e axhendës së integrimit rajonal me vendet fqinje. Në zbatim të Memorandumit të Tregtisë së Lirë nënshkruar në Bruksel më 27 Qershor 2001, brenda një kohe të shkurtër u negociuan dhe u nënshkruan marrveshjet e tregtisë së lirë me FYROM, Kroacinë, Bosnjë-Herzegovinën, Bullgarinë, Rumaninë, Kosovën, Serbinë dhe Malin e Zi.

Shqipëria vlerëson shumë seriozisht realizimin e këtij rrjeti marrëveshjesh si test kooperimi shumëpalësh dhe pararendës i integrimit europian duke mirëkuptuar deklarin se *“Integrimi në BE është i mundur vetëm nëqoftëse anëtarët e ardhshëm të mundshëm të tij do të demonstrojnë se ata janë të gatshëm dhe të aftë të bashkëpunojnë me fqinjët e tyre ashtu sikundër vetë vendet e BE midis tyre*¹⁵.

¹⁴ European Commission, Albania – Country Strategy Paper 2002-2006

¹⁵ Commission of the European Communities. **The Stabilisation and Association process for South East Europe, First Annual Report**, Brussels, April 4, 2002, COM(2002) 163 final

Referencat:

1. Monitoring Albania's path to European Integration, Published by the Friedrich-Ebert-Foundation, Tirana, February 2003
2. IMF Report, 1994
3. Trade policies and institutions in the countries of South Eastern Europe in the EU Association and Stabilisation Process, *Regional Report*, June 28, 2002, Poverty Reduction and Economic Management Group Europe and Central Asia Region, Document of the World Bank
4. Riccardo Faini, 2001. "Macroeconomic Stabilization during the Transition: Albania's experience in a comparative perspective." *mimeo*. Ministero dell'Economia and CEPR, December.
5. Bank of Albania, "Economic Bulletin", December 2001
6. Commission of the European Communities: Albania – Stabilization and Association Report, 2002
7. European Commission, "Albania – Country Strategy Paper 2002-2006", November 2001
8. "Albania – Stabilization and Association Report" – Brussels SEC (2002)
9. Bank of Albania, "Economic Bulletin", No.1, 2002
10. A. Mançellari, Growth and private sector development in Albania, Paper presented in PRSP forum, Baden, Austria, 2002
9. Georgi Ranchev, 2001 "Free Trade Zone in Southeast Europe? The Harmonization of Tax and Customs Legislation" Research Paper;
10. Të dhëna per Bilancin e Pagesave, botim i Bankës së Shqipërisë, Gusht 2002
11. European Commission, Albania – Country Strategy Paper 2002-2006
12. Commission of the European Communities. **The Stabilisation and Association process for South East Europe, First Annual Report**, Brussels, April 4, 2002, COM(2002) 163 final
13. "Transition. The First Ten Years", World Bank, 2002